



Tetor - Nëntor 2015    Botim i Qendrës, Agjencia AJMMI (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit)    Nr. 013



PEJZAZH VJOSE NË PËRMET (FOTO: SH.H-AJMMI)

*Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENiOR-A-“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është -financuar nga Qeveria Suedeze”*

## “Urat e Mjedisit”

është botim periodik i Qendrës “AJMMI” (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit). Në këtë revistë do të gjeni informacione dhe opinione mbi problematikat mjedisore kryesisht në jug të Shqipërisë si dhe çështje të lidhura me zhvillimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve në një rajon multikrahinor e multi-etnik.

është organizatë joqeveritare, A.JMMI jofitimprurëse e jopolitike, e përbërë nga specialistë me përvojë të mjedisit dhe medias që operon në fushat respektive të mjedisit dhe medias, përgjithësisht në rajonin Jonian, në jugun e Shqipërisë e me gjerë. Agjencia “AJMMI” është krijuar në vitin 2007.

**VIZIONI i Agjencisë “AJMMI: “Miqësor ndaj Mjedisit dhe një Media me fytyrë publike”**

### STAFI BOTUES

EDITOR: Shkëlqim HAJNO

### REDAKSIA:

Kryeredaktor: Dr Agim NELAJ  
Panajot BOLI, Blerim KORE  
Aferdita SELIMAJ, Sofokli MEKSHI,  
Xhorxhi VASILI

### KONSULENTË:

Për mediat:  
Arben Muka- DW, Tiranë  
Për mjedisin:  
Ing.Kristo Kauri

### ADRESA:

Agjencia “AJMMI”/Rr.”A.Çuni”,  
Nr.35.L.Nr.4, Sarandë/  
Tel/fax: 0852 25678 / 06922 35 026/  
0692708020

agency\_ajmmi@yahoo.com  
/ www.ajmmi.com

### NR. I LLOGARISE

SOCIETE GENERALE ALBANIA  
0001177415

### IBAN:

AL 9221363010000000001177415

### Qendra AJMMI OJF

Mbështetur nga REC Shqipëri

Shtypur në shtypshkronjën “Argjiro”, Gjirokastër  
Art Desing:  
Alda Muho

Mbështetur nga:



në kuadër të programit

**SENIOR-A** Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri

## NGA BRENDIA

### PROJEKSION: “Butrinti, harmonia magjike 3000 vjeçare...”

Zoti nuk gaboi që krijoi Butrintin. Por prapë mbetet i bukur dhe ne te gjithë duhet ta shpëtojmë nga aventurat dhe aventurieret e rinj.

3-10

Nga Ing.Kristo KAURI



### INTERVISTA: DELVINA, përpjekje për të dalë nga harresa...”

Në të vërtetë, prej gati 25 vjetësh Delvina dhe rajoni I nenprefektores nuk ka qene ne vemendje te qeverive shqiptare (-Me nenprefektin Vasil ARBACI-)

5

Intervistoi Shkelqim HAJNO



### FEJTON : “CENI, ROSAT DHE POLICIA”

Nuk më thua byazer: Kur vete të qahesh në kishë dhe ta menderos edhe prifti, dora vetë, ç'bëhet?...Ma thua dot këtë?!!

13

Nga Bejto Gjon LEKDUSHI

### TRADITA: “GJIROKASTER. Rikthehet tradita e kaldrëmeve”

Tingulli i çekanëve dhe daltave që skalisin gurët për kalldrëmet e gurta është rikthyer ditët e fundit në një prej rrugëve karakteristike...

4

Nga Blerim KORE



### FOKUS: “Bleta, insekt social”

Mbarështimi i bletës nxit ato pjesë të fjetura të pasioneve tuaja, ndoshta, edhe atë pjesë që njeriu e kërkon gjithë jetën.

6-9

Nga Dr.Agim NELAJ



### FOTOVEZHGIM: “Rrapi i Tranoshishtes “vdiq”...

Javët e fundit një motoshtarre i ka dhënë goditjen e fundit asgjësuese këtij objekti të shpallur “Monument Natyre”.

8

Nga Engjëllush SERJANI



### ESSE: Anton CEHOV: “Njerëzit e kultivuar”

Javët e fundit një motoshtarre i ka dhënë goditjen e fundit asgjësuese këtij objekti të shpallur “Monument Natyre”.

14

Përktheu: V.IFANDI



### MUZAT: - Fabula dhe Epigrame -

Nga Vasil GJIVOGLI

15

## **BUTRINTI, harmonia magjike 3000 vjeçare mes njeriut dhe natyrës**



**Nga Ing. Kristo KAURI**

Parku i Butrintit ndodhet ne skajin J-P te Shqiperise. Eshte nje nga parqet me te mira qe ka vendi yne. Per nga potenciali turistik, argetimi, kostoja e pushimeve, mikpritja, pozicioni gjeografik, e cilesuan Butrintin ne 10 Parqet me te mira te Evropes ne vitin 2015. Shume, studime, projekte, tryeza jane bere per kete margaritar te vendit. Pylltaret, biolloget shkencetaret, arkeologet e apasionuar investuan mendimet dhe shpirtin e tyre qe ky Park te mbetet ne nivelin e kerkesave te kohes. Shume nga keto studime projekte menaxhimi mbeten ne leter dhe i mbuloi pluhuri dhe pervec vlerave historike nuk u mbeti asgje tjeter. Dhe vete Parku indinjohet dhe revoltohet per kete ngadalesim ne menaxhimin e tij ne ruajtjen dhe rehabilitimin e vlerave te tij.

Shkurt: - 1948 Parku Arkeologjik shpallet Monument Natyre.

- 1981: Pylli i Butrintit shpallet zone e nje rendesie te vecante mjedisore.

-2000: Shpallet: " Park Kombetar Zona arkeologjike e Butrintit me Sip.25 km<sup>2</sup>". Perfshinte qytetin Antik te Butritit, liqenin e Bufit, Kanali i Vivarit dhe ligatinat qe e rrethojne.(Me VKM Nr.82 date 2.03.2000)

-2002:-Kompleksit ligatinor i Butrintit shpallet "Zone natyrore me rendesi nderkombetare dhe me siperfaqe 13.500 ha".( VKM Nr.531 date 21.10.2002)

-2005: - Kompleksi ligatinor i Butrintit shapallet Park Kombetar me sip.8.591.2 ha. (VKM Nr.693 date 10.11.2005)

-2013: "Park i Butrintit me siperfaqe 9.424.4 ha" (VKM Nr. 134 date 20.02.2013)

Eshte pikerisht ky harmonizim i rralle dhe magjik i peizazheve natyrore, historike-kulturore, kjo larmi e madhe habitatesh, speciesh me nje vlere te jashtezakonshme, qe e bejne te vizitueshem nga qindra mijera turistet dhe e vecuan si pasuri nderkombetare. Historia. Fillimet i ka ne shekullin e XVIII Para Krishtit. Qyteti i lashte i Butrintit banohej ne kohen e hershme

nga iliret. Germimet arkeologjike deshmuane se ka qene nje zone e rendesishme e banoreve ilire, ekaoneve nje nga fiset me te medha. "E pashe veten perpara Trojes ne miniature" citoi Enea kur u perball me Butrintin. Kjo shprehje e famshme e Eneas vazhdon te ngjall kureshtjen anekend dhe secili deshiron te ndjeje te njejten ndjesi. Virgjili ne poemen e madhe "Eneida" vazhdon "na ikin syresh malet e Faekeve, kalojme ne fund te brigjeve te Epirit dhe hyjme ne portin e Kaonise dhe jemi prane qytetit te larte Butrot..."

Butrinti eshte nje thesar i arkeologjise jo vetem shqiptare por i gjithes mesdheut dhe me gjere. Historia e tij mijevjecare shikohet ne renojat antike qe nga periudha e Ilireve, Grekeve te lashte, Romakeve, Bizantineve, Venecianeve, Otomaneve e deri ne ditet e sotme.

Kane shkruar Hekateu ---- (VI PK), Straboni, Teukri, Dionisi i Halikarnasit, Ciceroni, Virgjili etj. Pas pushtimit romak u vendosen kolonet Romake, me pas pati dyndje barbare (byzantine, normane, napolitane, veneciane).

Butrinti eshte perfshire nga UNESCO ne listen e "Trashegimise kulturore boterore", ndersa parku natyror ben pjese ne zonen nderkombetare te pasurive natyrore te Mbrojtura Ramsar. Qyteti antik sot administrohet nga Parku Kombetar i Butrintit nje administrate e krijuar nga Qeveria Shqiptare.

Butrinti ishte gati i panjohur deri ne vitin 1920 kur ne Butrint erdhi misioni Italian me ne krye Luixhi Ugolinin. Student i apasionuar i universitetit Bolonja, Konti Ugolini me gjithes veshtiresite brenda tre muajve ne vitin 1926 beri zbulime te medha qe vijuan. Duke u bazuar tek poema e Virgjilit "Eneida" zbuloi margaritarin njeri pas tjetrit. Nder objektet arkeologjike me mjaft vlere jane Koka e Deas, Koka e Aleksandrit te Madh, Agustit, Agripes, Livia, teatri, Baptirsteri, Tempujt (Tempulli i Eskulapit) mbrojtjesi i qytetit, pusi i nimfave, Akropoli etj. etj.

Ugolini do te vazhdonte germimet, por e nderpreu vdekja nga malarja ne moshen 41 vjecare ne qytetin antik te Butrintit.

Butrinti ose Buthroti, rezidenca e aristokracise ilire, Athinjotasve, Romake, Veneciane etj., ende ne ditet e sotme shfaqet me pamjen e dikurshme magjepsese, hyjnore, befasuese, shokuese qe e bejne unik ne Ballkan dhe ne gjithes boten.

Vizitoret e famshem te Butrintit

Nga lashtesia i pari e viziton princi i Trojaneve Enea ("Eneida" poema), Helen i biri i mbretit Priam te Trojes, vijon me Julios Cezar, filozofin e shquar romak Ciceronin, Duka i Venedikut Dandolo, Sulltan Sulejman (shek. XVII) Ali Pashe Tepelena (XIX) Eduart Lear, Leon Duple, Lord Bajroni etj. Te gjithes kane qendruar dhe patur rezidenca e vila ne Butrint. Ne vitin 1938 vizitohet nga breti Zog, 1959 Nikita Hrushov, Ten Siao Pin, Lordi Kerington, e mjaft burra shteti u perulen perpara fuqise magjepsese te ketij qyteti antic.

Klima dhe natyra.

Nje klime tipike mesdhetare subtropikale me shira vjetor 1450 mm/vit, por me nje shperndarje shume heterogjene dhe te crregullt nga cdo rajon i vendit. Duke filluar nga ora 10.00 paradite deri ne oren 16.00 atmosfera e Parkut freskohet nga puhia detare. Lageshtira ajrore 62% eshte e favorshme per bimesine karakteristike te vendit. E s h t e

vijon në fq 10

## Gjirokastër: Rikthehet tradita e kalldrëmeve

Mjeshttrat gurgdhendës në qytetin e Gjirokastrës po ripërtërijnë traditën e shtrimit me kalldrëm të rrugëve të brendshme të qytetit. Pas viteve '90-të si shkak edhe i largimit të gurgdhendësve në emigracion, ky zanat u zbeh. Së fundi në qytet është rikthyer tingulli i çekanëve të skalistëve të gurit që punojnë për shtrimin me “qilima guri” të rrugëve në pjesën muzeale.

### Mes skalitësve te gurit në rrugët e kalldrëmta

Tingulli i çekanëve dhe daltave që skalisin gurët për kalldrëmet e gurta është rikthyer ditët e fundit në një prej rrugëve karakteristike që lidh zonën muzeale me lagjen “18 shtatori”. Rruga “Lufta e Mashkullorës” ka nisur të zhurmojë nga gurgdhendësit dhe mjeshttrat e skalitjes së gurit, të cilët po punojnë për restaurimin e kalldrëmit të gurtë. Kjo rrugë karakteristike u dëmtua gjatë punimeve për ndërtimin e ujësjellësit të ri të qytetit, ndërkohë që firma zbatuese e punimeve ka marrë përsipër rikonstruksionin e pjesës së dëmtuar. “Pjesë e punimeve për ndërtimin e ujësjellësit të ri të Gjirokastrës, është edhe rehabilitimi i segmenteve rrugore të dëmtuara gjatë punimeve duke përfshirë edhe rrugët e kalldrëmta në qytet”, shprehet projekt menaxheri, Admir Martini. Por punimet rehabilituese nuk kanë përfshirë vetëm pjesën e dëmtuar gjatë shtrimit të tubacioneve por kanë përfshirë pjesën më të madhe të rrugës së kalldrëmtë duke bërë të mundur restaurimin e plotë të saj. Gurgdhendësi Xhelo Rondo shprehet se gjatë muajve të fundit ka punuar për shtrimin me kalldrëm të disa segmenteve rrugore. “Në Gjirokastër po rikthehet tradita shekullore e shtrimit me kalldrëm të rrugëve të qytetit. Gjatë muajve të fundit unë kam punuar për shtrimin me kalldrëm të pedonales që lidh qytetin me Parkun e Viroit si dhe në disa kalldrëme në lagjet muzeale”, pohon ai. “Gjithmonë e më shumë ne po kryejmë punime për rikonstruksionin e rrugëve të kalldrëmta në Gjirokastër duke i dhënë më shumë bukuri qytetit edhe për turistët”, shprehet gurgdhendësi Beni Baxha.

### Rikthehen mjeshttrat gurgdhendës nga emigracioni

E veçantë është se krahas fondeve të akorduara nga qeveria, për shtrimin me kalldrëm të rrugëve të qytetit po ndihmojnë edhe biznesi lokal si dhe organizatat jofitimprurëse. Zbatimi i nismave të tilla po krijon mundësinë e punësimit të mjeshtrave gurgdhendës të kthyer nga emigracioni. Mërkur Shameti, për 20 vite ka punuar në Greqi si gurgdhendës. “Pasi u ktheva këtu në Gjirokastër së bashku me familjen fillimisht e pata të vështirë të punësohesha por me kalimin e kohës u shtuan punimet me gur të skalitur dhe veçanërisht shtrimi i rrugëve me kalldrëm”. Ai e ndërpret bashkëbisedimin për të latuar me daltë dhe çekan një prej gurëve dhe më pas plot kujdes e vendos në rradhën e kalldrëmtë. “Tashmë, vazhdon bisedën gurgdhendësi, kam punuar në disa raste të tilla



Nga Blerim KORE

si në shtrimin me gur të skalitur të pedonales së Viroit, disa rrugë në lagjet muzeale, etj”.

### Tradita përcillet tek të rinjtë

Pjesë e grupit të gurgdhendësve që punojnë për restaurimin e rrugëve të kalldrëmta në Gjirokastër po bëhen edhe të rinjtë. Me kalimin e kohës kjo mjeshtri po përcillet tek të rinjtë duke krijuar mundësi jo vetëm për vazhdimin e traditës por edhe për punësimin e tyre. I riu Tomor Baxha vazhdimisht ka punuar me gurgdhendësit me përvojë duke bërë të mundur mësimin e këtij zanati. Me çekatin në duar ai skalit plot dëshirë gurët e kalldrëmeve në Gjirokastër duke i përngjasuar mjeshtrove të vjetër të qytetit. “Filimisht kam punuar disa vite në punime të ndryshme me gur dhe me kalimin e kohës arrita të mësoja zanatin e gurgdhendësit.

vijon në fq 5



# DELVINA, përperjekje për të dalë nga harresa...



Me nënprefektin e Delvinës,  
Vasil ARBACI

**Cfar duhet te ndryshoje ne politikat e qeverise per ta nxjerre Delvinen nga harresa?**

**-V.Arbaci:** -Ne te vërtetë, prej gati 25 vjetesh Delvina dhe rajoni I nënprefektures nuk ka qene ne vemendje te qeverive shqiptare. Per kete flet largimi I disa zyrave dhe drejtorive nga Delvina ne drejtim te Vlores ose Sarandes. Sot, nje bari per te kerkuar psh te lidhe nje kontrate per shfrytezim kullote ne nje fshat te bashkise Finiq, duhet te udhetoje nga Zmineci (ne kufi me Greqine), drejt Vlores ne drejtorine rajonale te sherbimit pyjor. Mund te permend edhe drejtori apo zyra te tera ,per te mos kujtuar faktin qe Spitali I Delvines ka godine por nuk ka emerime mjekesh, megjithes mjeke ka pa pune...!Per nje vizite te patologu se gjinekologu, qytetareve u duhet te marrin rrugen per te shkuar ne Sarande. Perperjekje per te thyer vemendjen nga Delvina po shikojme aktualisht me qeverine Rama.

**Ne fushaten elektorale te fundit degjuam premtime per nje ceshtje jetike si ndertimi ujesjellesit te ri te Delvines. C'mund te na thote nenprefekti per kete ?**

**-V.Arbaci:** -Populli I urtë i Delvines ka pritur nje zgjidhje prej vitesh ne kushtet e ujit te ndotur te Vrisit. Mund te informoj

nepermjet revistes "URAT..." se me ndertimin se afermi te ujesjellesit te ri nga burimet e Tatzatit, do te marre fud edhe legjenda e ujit ne Delvine. Kujtoj se ky ujesjelles do te furnizoje edhe Saranden, edhe Delvinen dhe eshte investit prej mbi 6 milione eurosh.

**Rruga e re nacionale Kardhiq-Shijan (Delvine) pritet te kete impakt pozitiv edhe ne zhvillimet ekonomike te Delvines. Pasi u la ne mes ky investimi, megjithes dy perurimet e fillimit te punimeve ne 2008-en, nga ish kryeministri Berisha;-sot , a mund te mesojme nga ju ndonje info te re se kur mund te rinisin punimet ?**

**-V.Arbaci:** -Kjo rruge do te rinise te ndertohej nga qeveria Rama. Ne dijenine time, 50 per qind e investimeve do te mbulohet nga financime te BE dhe 50 per qind nga fonde te qeverise shqiptare. Kjo rruge eshte mese jetike per zhvillimet ekonomike turistike e sociale ne te gjithes nenprefeturen e Delvines dhe krejt rajonin JP te Shqiperise ,po edhe nje favor I madh per fshatrat e rajonit te bashkise ne ish komunen Vergo.

**Por jo çdo fushe harrese ne Delvine lidhet me Tiranen...Pothuaj asgje nuk eshte bere nga pushtete locale per promovimin e Delvines ne fushe te monumenteve, traditave kulturore, artistike, artizanale, etj.. Vetem 10 m nga Bashkia, prej vitesh nje godine e pretenduar si Muze, mund te lexohet si monument I paafesise, dhe pazotesise totale se bashkive per te ngritur nje muze dhe qyteti te kthehet ne nje destinacion tursitik. Komenti juaj?**

**-V.Arbaci:** -Une kam bindjen se bashkia e Delvines me krejtarin e saj Rigels Balili gjate 2016-s do ta ngrene muzen e munguar deri me sot .Nga ana ime, nuk do te mungojne angazhimet mbeshtetur ne eksperiençen jo te vogel qe kam si ish drejtues I komuns Finiq,etj.. Delvina e meriton Muzeun dhe shume me shume se kaq: Nje rrjet sinjalistike turistike dhe urbane funksional, nxitje te investimeve dhe kthim te vemendjes per rikthimin e disa sherbimeve sa me prane komunitetit te banoreve delvinjote jo vetem ne qytet por edhe per 17 fshatrat e bashkise Delvine dhe 56 fshatrat e bashkise Finiq..

(Intervistoi :SH.HAJNO)

vijon nga fq 4

## Gjirokastër: Rikthehet tradita e kalldrëmeve

Së fundi kam punuar për shtrimin e disa kalldrëmeve në qytetin e Gjirokastrës”, thotë Tomori ndërsa së bashku me mjeshtrat e vjetër skalit gurët e rrugës së kalldrëmtë. “Për mua është një zanaa që e bëj me dëshirë pasi qysh në moshë të vogël kam dëgjuara çekanët e gurgdhendësve në rrugët e kalldrëmta duke parë edhe punën që bënin. Përpiqem që me kalimin kohës të mësoj sa më shumë nga ky zanat duke iu përngjasuar atyre për të skalitur kalldrëme që ti rezistojnë kohës”, thotë gurgdhendësi i ri.

### Domosdoshmëri mirëmbajtja e kalldrëmeve

Zhvillimi i turizmit dhe fluksi në rritje i vizitorëve vendas dhe të huaj në Gjirokastër po nxjerr si domosdoshmëri zbatimin e projekteve mirëmbajtëse në rrugët e kalldrëmta. Së fundi me fondet e akorduara nga qeveria u mundësua restaurimi i rrugëve të kalldrëmta që përshkojnë lagjet Varosh dhe “11 Janari”, rruga që të çon në banesën e shkrimtarit Ismail Kadare, shtrimi me gurë të skalitur i pedonale Gjirokastër-Parku i Viroit, etj. Sipas specialistëve të trashëgimisë kulturore, Gjirokastra e UNESCO-s nxjerrë si domosdoshmëri mirëmbajtjen e rrugëve të kalldrëmta si një prej vlerave unikalë dhe të papërsëritshme të qytetit. Aktualisht në qytetin e gurtë, ka 9 km rrugë të shtruara me kalldrëm ndërkohë që një pjesë e tyre është e dëmtuar. Kjo problematikë ka ardhur edhe si shkak i lëvizjes së automjeteve në to.

Nga Blerim KORE

## Bleta, insekt social!



Nga Dr. Agim NELAJ

Bletët janë insekte sociale dhe jetojnë në koloni. Cdo koloni është një njësi familjare që përfshin një femër të vetme (mbretëresha), e cila depoziton vezë, kurse bijat e saj të shumta, jo riprodhuese quhen punëtorë, merren me mbledhjen e ushqimit me ndërtimin e hojeve dhe ushqimin larvave. Meshkujt mbarështohen vetëm në atë periudhë të vitit kur është e domosdoshme. Njeriu ka njohje të hershme të bletëve. Aristeu si ka qënë rritësi i parë i bletëve. Një ditë të gjitha bletët e tij vdiqën. Perënditë e ndëshkuan për diçka të keqe që ai kishte bërë. Më vonë perënditë e kishin urdhëruar të flijonte një dem për të treguar se ishte penduar, pastaj të kthehej pas nëntë ditësh tek skeleti i kafshës dhe të shikonte brënda tij. Ai bëri pikërisht siç i kishin thënë dhe kur u kthye, pa një roji bletësh (familje blete) duke fluturuar jashtë skeletit të demit. Bletët e tij, po të ringjallura. I çojë tek zgjoji i vet, dhe që atëherë njerëzit besuan se bletët ishin hyjnore, dhe kishin pushtet mbi vdekjen. Mbretërit në Greqi i bënë varret e tyre në formë zgjoji.

### Jeta sekrete e bleteve.

Njerëzit shpesh nuk e kanë idenë sa e ndërlikuar është jeta brënda zgjoit. Bletët kanë një jetë sekrete për të cilën dimë pak. Unë nuk dua të zgjatem për jetën sekrete të bletëve. Por nuk mund të lë pa përmendur bletën punëtorë. Janë ato që ndërtojnë hojet, Me siguri që janë "gjeni në gjometri" me ata gjashtëkëndësha të përsosur që krijojnë, që të lënë përshtypjen se i kanë bërë me "vizore". A është kjo vetëm një dhunti?

Po mbretëresha? Ka sekrete të shumta. Ajo ka "oborr mbretëror", rreth saj janë një grup "zonjushash nderi", që e ushqejnë, i bëjnë fresk ose e mbajnë ngrohët sipas nevojës. Gjithëmon bëjnë diçka rreth saj. Kam vënë re se madje edhe e përkëdhelin... Bletët prodhuese të mjaltit varen nga kolonia, jo vetëm për kontaktin fizik, por edhe për shoqërim dhe mbështetje sociale. Nëse një bletë

izolohet nga motrat e saj, ajo shpejt ka për të vdekur. Po në dimër kur është acar? Ndodh një fenomen shoqëror i veçantë. Familja e bletëve formon një lëmsh. Në qëndër të lëmshit vendoset Mbretëresha. Ajo mbrohet nga të ftohtit. Po bletët që janë në sipërfaqe të lëmshit ku temperatura është vdekjeprurëse për to? Ky është një moment ku bletët shfaqin një nga vetitë më sociale të jetës së tyre. Ato ndrojnë vendet me bletët që janë vendosur më në thellësi të lëmshit, dhe kështu i shpëtojnë vdekjes së sigurtë.

### Bletari dhe Mbretëresha

Mbretëresha në vetvete është forca unifikuese e kësaj bashkësie që numuri i saj arrinë deri 60 -80 mijë bletë, në kulmin e zhvillimit (pranverë -verë). Mbretëresha (mëma), nëse ajo për çdo arsye largohet nga zgjoji (vdesë, humbet, dëmtohet), bletët punëtorë shumë shpejtë e ndjejnë mungesën saj. Mbas disa orësh ose dhe më pak, ato shfaqin shënja të pagabueshme të mungesës së një udhëheqje.

### Përfjetimi i një bletari.

Ishte hera e parë që afrohesha në një bletore. Bletari që më udhëzonte ishte një profesionist i zoti. Ai më dha një leksion fillimisht që equajti "Etika e sjelljes në një bletore". Kështu u futa në botën e bletëve. Fillimisht përfytyroja për një çast, sikur të isha aq i vogël, sa që mund ta ndjek bletën brënda zgjoit, përsëri do ta kisha të vështirë, se është errët...

...Dëgjoja një zhurmë, më dukej sikur vinte nga diku larg. Mbështes kokën tek zgjoji, ndëgjoja si një gurgullim të një ibriku që vlon, një zhurmë gumëzhitje po ngjitej lart. Eshtë zhurma e mijra bletëve që e vënë ajrin në lëvizje. Mbylla sytë, për tu përqendruar, siç bëjnë njerëzit në koncertin e një orkestre të madhe që luan muzik klasike. Them se nuk do të quhej e tepruar, po të pohoj se nuk kisha dëgjuar kurrë në një hai-fain e shtëpisë një harmoni aq të ëmbël. Duhet ta kishit dëgjuar

me veshët tuaj për të kuptuar se sa të përsosura janë intonacioni, ritmi, si dhe ndryshimi i vëllimit të zërit. Isha mbështetur e ngjeshur te një kuti gjigante muzikore. U harrova fare se ku isha, me sytë mbyllur, ishte një ëndër që nuk e kisha përjetuar më parë, gati i larguar nga jeta, në gjysmë vetëdije... Kur më mungon zhurma e bletëve, ishte njësoj sikur më mungon mermërima e detit. Nuk kisha kuptuar se sa shumë i sigurt ndihesha me të. Qetësia, ka një uturimë të çuditshme që gati të çanë timpanine veshit.

Njerëzit ende nuk kuptojnë sa të zgjuar janë bletët, edhe më shumë se elfinët...

Organizimi i familjes, ka pyetje pa fund.

Bletët prodhuese të mjaltit varen nga kolonia jo vetëm për kontaktin fizik, por edhe për shoqërim dhe mbështetje sociale. Në se bleta izolohet nga motrat e saj, ajo shpejt ka për të vdekur. Ajo është specia më e evoluar nga klasa entomologe..

-Familja e bletëve shquhet për organizim të përsosur, edhe për veprimet po kaq të sofistikuara dhe të harmonizuara më një saktësi të çuditshme.

Më herët, duke mos e njohur shkencërisht bletën dhe organizimin në familje, jepeshin gjykime mistike. Duke njohur proceset, organizimin dhe aktivitetin jetësor, u bënë të qarta fenomene të shumta dhe shpjegimet shkencore të tyre.

vijon në fq 9

## FOTO - REPORTAZH



*-GUIDE TURISTIKE dhe nje imazh i ri ne Tepelene...Qyteti i A.P.Tepelenes, po del nga muguajt e harreses! Duke kerkuar kohen e humbur; duke kerkuar te përfshihet ne hartën turistike te Shqiperise; në një te ardhme të afërt me Muzeun Historik dhe Etografik; me Muzen kaq shumë të munguar të Ali Pashës, në rezidencën pritëse për Lord Bajronin; me një ZIT (Zyra e Info.turistik ) për resurset historike, arkitektonike dhe ekoturistike; me një imazh dhe rivlerësim urban; dhe, shumë të tjera për t'u zbuluar....Më në fund në Tepelenë, NJE DASHURI ME SHUME PER QYTETIN dhe njerëzit e tij; një vullnet i ri për të flakur pluhurin e harresës nga qeveritë dhe vetë administratorët e saj!..Hapa të mirëpritur nga të gjithë. -*



**RRAPI I  
TRANOSHISHTES  
“VDIQ”**

*Tranoshishte 10.10.2015.*

*Kjo pamje eshte ajo çfare ka mbetur nga Rrapi Shumeshekullor i Tranoshishtes. Pamje e trishtueshme. Ne fëmjërinerine time Rrapi i Tranoshishtes ishte nje nga pemet me madheshtore qe kisha pare. Deget e nxira te tij ishin deshmi e rrufeve qe e kishin goditur neper vite e shekuj. Ndersa zgavra e madhe ne trungut, ku mund te qendronin ne shi deri ne 10 se bashku, ishte deshmi e degradimit te kesaj peme madheshtore. Vitet e fundit trangu dhe deget e mbetura u benerrezik per jeten e banoreve. Javet e fundit nje motosharre i ka dhene goditjen e fundit asgjësuese ketij objekti te shpallur “Monument Natyre”. Sidoqofte, ajo ç ka mbetur eshte nje pamje trishtuese. Rrapi i Tranoshishtës “vdiq”.....*



**Cast: Aktori i njohur sarandiot ANASTAS NIKA duke interpretuar ne studio radiofonike**



**Djaloshi dhe qengji.....  
(FOTO: SH.H-AJMMI)**

## Bleta, insekt social!



Ndonëse ende ka fenomene dhe tërësi marrëdhëniesh midis pjestarëve të familjes që kërkojnë studime të mirëfillta, për ti kjarësuar. Në familjen e mjaltëbërseve, ne shohim me mijëra individ të cilët qëndrojnë pranë të vetmes mëmë (Mbretëreshë) duke formuar një bashkësi biologjike unike, si asnjë tërsi tjetër. Pjestarët e kësaj bashkësie, kanë të vetmen mundësi veprimtarie brënda kolonisë. Asnjë pjestarë nuk mund të ekzistojë jashtë bashkësisë. Të organizuar deri në perfeksion brënda bashkësisë, kanë zotuar aftësi të shquara për ti rezistuar ndryshimeve mjedisore, për ekzistencë. Pikërisht aftësia për të luftuar për mbijetesë, shfrytëzohet në praktikë nge bletarët.

Nuk ka shkencëtar, specialist të mirëfilltë të fushës së bletarisë që mund ta njohi më mirë se bletari, familjen e bletëve (parkun e tij). Çdo familje ka veçori specifike. Vetëm ai që e ka ndjekur ecurin, gjëndjen, rezerva ushqimore, mbretëreshën, pjelljet, daljen nga dimri, prekjen nga sëmundje etj mund të orjentohej dhe të gjej rrugën e zgjidhjes.

Studiuesi, shkencëtari sjell informacionin më bashkohor, që është një vlerë e shtuar e pazëvendësueshme në fushën e bletarisë. Por e rëndësishme është që bletari të ketë aftësin e njohjes së tyre, me qëllim që në zgjidhjen e dilemave, vështirësive të ketë informacionin nevojshëm.

Ndërmjet fenomeneve që i tërheqin vëmendjen bletarit, nga të cilat i lindin pyetje normale ndër to do veçojmë:

-Cili është ai kod që i bashkon disa

dhjetra mijëra individ në një tërësi unike.?

-A është misterioze aftësia e bletëve për të kuptuar Mbretëreshën?

-Pse ende është e pakuptueshme zëvendësimi i mbretëreshës me një të re?

-Kujt i dedikohet, cili është ai kod gjenetik që e kalon pragun e instiktit, që të jep përshtypjen e "arsyetimit" për momentet më vendimtar në jetën e familjes.?

-A janë të fshehura shikimit tonë fenomene të tilla.?

-Pse këto fenomene miratohen gjithëshe nga të gjithë pjestarët e familjes?

-A ka raste që ndonjë fenomen nuk miratohet nga të gjithë pjestarët?

-Po aftësia e familjes për të vlerësuar gjëndjen e Mbretëreshës, p.sh moshën, ose arsyen pse duhet zëvendësuar.?

-Për ç arsye bleta punëtore vendos vetë vezë të pafekunduara, në ato raste kur Mbretëresha ka paftësi riprodhuese ose mungon?

-Pse nuk jetojnë bashkë dy mbretëresha, ose në raste të tjera qëndrojnë bashkë? Enigmat janë pa fund.

A vepron individualisht bleta punëtore?

Midis morisë së bletëve punëtore, ka nga ato që marrin inisjativën, për të zgjidhur një situatë të vështirë?

Pikërisht këto dhe pyetje të tjera pa fund, e intrigojnë njeriun, jo vetëm të hulumtoi të ndjekin me kujdes etapat e ecurisë së familjes, por i nxitet pasioni, që nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër në natyrë.

Vështirësia për të zbuluar të fshehtat nuk është diçka e rastësishme. Vetëm për të vlerësuar dhe njohur momentet e dukshme ka patur ngandalsi. Kështu për të zbuluar seksin tek Mbretëresha që është diçka e dukshme do duhej dy shekuj (nga seksi deri tek fekondimin).

Ndonëse aktualisht shkenca ka mundur të shpegojë disa prej këtyre të fshehtave, përsëri ngel ajo pjesë misterioze e PS-eve.

Sa më shumë njohuri të kemi për bletën, aq më i gjërë është rrethi i

gjërave të paditura.

Sa më shumë ë të njihen të fshehtat e bletëve, aq më tepër interes praktike ka. Studimet e sotme mbi biologjinë e Mbretëreshës, vërtetuan se ajo nuk është vetëm riprodhuese. Ajo kryen një sërë veprime, nëpërmjet të cilave ruhen marrëdhëniet organike, unitetin dhe aktivitetin e bashkësisë. Kërkimet në këtë fushë të errët, ndriçuan një ndër fenomenet më interesante, zbulimin e lëndëve që prodhon Mbretëresha që njihen me emrin feromone.

Këto lëndë kanë një efekt magjik për: -Bashkimin e individëve në një sistem unik biologjik.

-Organizimin dhe ndarjen e detyrave midis pjestarëve të kolonisë.

-Frenon aftësin riprodhuese tek punëtoret.

-Diferencon instinkt të tyre amëtare.

-Mbretëresha, vetëm ajo, pjellë vezë të fekunduara-

-Bletët kujdestare interesohen për mirërritjen e pjelljeve etj

Ne, njerëzit kur dëgjojnë termin "Mbretëreshë" menjëherë projektojmë të gjitha atributet mbretërore të udhëheqjes dhe mbifuqinë e saj në koloni. Por a është kjo me të vërtetë

një rastësi? Apo bleta mbretëreshë me të vërtetë "sundon" koloninë, me punëtore sterile që veprojnë si subjekte vartëse? Etj.

Meditoni pak më gjatë. Si mund të zgjidhni një gjë a gjëzë. Ju po hyni në botën e bletëve, gjykoni se po i futeni një aventure të mrekullueshme, (bletaria), që do tua ndryshojë jetën tuaj. Efektet e saj pozitive do ti ndjeni shpejtë, sa të marrësh kontaktin e parë me një familje blete.

Njeriu ka dy gjëra, njërën prej të cilës e kërkon gjithë jetën. Mbarështimi i bletës nxit ato pjesë të fjetura të pasioneve tuaj, ndoshta edhe atë pjesë që njeriu e kërkon gjithë jetën.

**Nga Dr. Agim NELAJ**

### **BUTRINTI, harmonia magjike 3000 vjeçare mes njeriut dhe natyrës**

pikerisht kjo klime me diell te nxehte, ajrin e kendshem, nje klime e privilegjuar per limonin, portokallin, ullirin, palmen, bananen, ilqen, dafinen, xhixhibanozin etj.

Venedikasit e kane quajtur kete vend "VIVAR" qe do te thote "Rezervuar jete". Ky himn madheshtor i natyres me bukurine magjepsese te detit, liqenit, kanali i Vivarit, ishujve te Ksamilit (Tetranisa)pylli i Milese, i Butrintit, larmia e zogjve, peshqve, larmia e ngjyrave te bejne per vete dhe te detyrojne, imponojne te shkosh shume here per t'i vizituar ato. Eshte nje harmonizim i ralle (unik ne vendin tone) te peisazheve te natyres, historike- kulturore me vlere te jashte zakonshme. "The Guardian" gazete prestigjose nenvizon ne vitin 2012 "Butrinti eshte destinacioni i turizmit boteror". Mos u kthe mbrapa pa vizituar Butrintin, keshillonte vajzen e tij Bill Klinton qe kishte vajtur per vizite 2.5 km larg tij ne ishullin e Korfuzit.

#### **Peizazhi dhe habitatet**

Gjate ketyre 3000 viteve kemi dhe ndryshime ne peisazh. 3000 vjet me pare liqeni i Butrintit ishte pjese e detit dhe formonte nje gji bregdetar. Parku i Butrintit permbledh nje larmi habitatesh (natyror, gjysem natyror, artificial). Karakteristika e Parkut eshte se ka nje diversitet habitatesh brenda nje shtrirje te vogel gjeografike. Jane rreth 30 llojesh habitatesh...Shfrytezimi pa kriter nga nje aktivitet bujqesor intensive ka cuar ne uljen e numrit te drureve dhe ne disa vende eshte i kercenuar per zhdukje.

#### **Flora dhe fauna...**

Eshte shume i pasur dhe e larmishme e perbere nga 800-900 lloje bimesh.

Libri i kuq vecon 32 bime ne Butrint me status kombetar jo te favorshem te ruajtur.

16 prej tyre jane te rrezikuara, 12 te rralla, 4 jo te njohur dhe nje lloj endemik

Ne lloje te kercenuara Laurus nobilis, quecus ilex, S. officinalis, Satureja Montana etj.

Iintervetebroret: 5 lloje sfungjeresh, 12 llojekrustacesh, 21 lloje gasteropodesh, 149 lloje fluturash.

Nga te dhenat e literatures ne PKB ndodhen 1500-2000 lloje insektesh.

**P e s h q i t :**  
Larmia e burimeve ujore (ujera te embla, te kripura) krijon dhe larmin e peshqve. Takohen 105 lloje qe perfaqesojne 33% te gjithë Shqiperise. Liqeni i Butrintit

popullohet nga 68 lloje peshqish. Eshte kjo larmi peshqish qe per shume vite kjo zone eshte pushtuar apo marre me qira nga venedikasit. Amfibet: Ne PKB perfaqesojne 67 % te llojeve ne Shqiperi dhe Reptilet: 75%.

Shpendet: Vrojtimit kane identifikuar 246 lloje shpendesh. Ligatinat jane zonat me te rendesishme per shpendet. Aty strehohe me shume se 8000-9000 individe (dimeronjes) Rosat, Shapkat, Koliku, qyryliku, gjelezat, pulebardha, dallendyshja jane me te perhapurat. Gjitarat: Jane regjistruar 39 lloje nga 74 qe ka vendi yne (53%) Lakuriqet e nates, dhelpra, derri i eger, cakalli, ujku, lepuri i eger etj. Mbi kullotja dhe djegiet gjate viteve e kane zvogeluar kete pasuri.

E vetmja zone ne Shqiperi qe ka bretkocen e Epirit (Ranus Epirotica) dhe breshken e ralle (Testudo marginata)

#### **Sfidat:**

Mbrojtja e ekosistemeve dhe habitateve nje menaxhim i drejte dhe shkencor eshte domosdoshmeri per ngritjen e vlerave te Parkut. Konventa mbi diversitetin biologjik (Per nje menaxhim e perdorim te qendrueshem, Program i Unescos mbi raportet e njeriut dhe Biosfera, Konventa e Bernes ( per ruajtjen e flores dhe faunes, Konventa e Barcelones, per mbrojtjen nga ndotja, krijuan nje vision te ri per zonat e mbrojtura.

Rehabilitimi i pyjeve te degraduar, (rrejedhoje e demtimeve, zjarreve kullotjes, sidomos ne zonen qendrore A dhe B, pyllzimet me llojet autoktone (valanidh, bung, dafine, ilqe) i mbi 150 ha, pastrimi i territorit nga ndertimet pa leje mjedisore, rehabilitimi i ishujve te Ksamilit nga ndertimet dhe djegia, punimet permiresuese te kullotave ne zonen e zhvillimit tradicional do te krijoje e kuilibre te reja. Te ruhen raportet deti, liqeni ligatina, toka-gjelberimi. Te vendoset nje strategji urgjente per menaxhimin e territorit.

Parku Kombetar i Butrintit eshte nje korridor ekologjik, ekosistem qe na lidh me Evropën. Ishujt e Ksamilit, Pylli i Butrintit, Liqeni i Rrezes-Xarre, kanali i Vivarit, Burimet e kripura te Rrezes. jane pese Monumente qe duhen pare me seriozisht.

Plani i menaxhimit i ristudjuar do te jete instrument qe do te garantoje zhvillimin e qendrueshem te zones do te harmonizojë aspektet sociale- ekonomike- mjedisore, do te jete nje udhezues mbi perdorimin e territorit dhe ruajtjen e promovimin e vlerave natyrore te Parkut.

Vija bregdetare e Parkut eshte pjese e trashegimise natyrore dhe nuk duhet lejuar pronesi private ,si fshatra turistike, aquaculture etj.. Zhvillimet kaotike urbane ne qytetin e Ksamilit, Berdenesh, Manastir, Shendelli kane prishur imazhin dhe tjetersuar mjedisin duke ulur vlerat turistike, mjedisore. Ate qe nuk e bene "armiqtë" gjate 3000 viteve e beme ne per 25 vjet. Nje marrezi kolektive qe duhet marre fund. Pervec vlerave natyrore kulturore te parkut duhet te ekzistojë dhe deshira dhe vullneti i mire i komunitetit qe ndodhet ne brendesi dhe rreth tij per ta mbrojtur kete margaritar se deri tani nuk eshte ne nivelin qe kerkohet. Permiresimi i nivelit te produktit turistik qe ofrojme (hotelet) restorantet kultura e sherbimit, do te permiresojë imazhin, deshiren per t'u rikthyer dhe legjendat do te jehojne me mire ne gjithë territorin e PKB. Ndihejmi jo pjestar por pergjegjes per te ardhmen e PKB kesaj trashegimie qe eshte me e madhja ne vendin tone.

Zoti nuk gaboi qe krijoi Butrintin, ne gabuam duke prishur kete harmoni magjike mbi 3000 vjecare. Por prape mbetet i bukur dhe ne te gjithë duhet ta shpetojme nga aventurat dhe aventurieret e rinj.

**Nga Ing. Kristo KAURI**



Event: Anija antike "ARGOS" e rindertuar ne Greqi sipas teknologjise se lashte ne vitin 2008, në destinacionin e fundit, Sarandën



AJMMI - FOTO MEMORIE- AJMMI - FOTO MEMORIE- -AJMMI - FOTO MEMORIE- - AJMMI - FOTO MEMORIE- -



Grup nxënesh të gjimnazit "Hasan Tahsini" te Sarandes ne vitet '80, duke mbjelle peme ne nje fushate pyllezimi

## Me syrin e nje 80 vjecari

*Tashme ne moshen 80 vjecare inxhinjeri i pyjeve dhe kullotave, I shqetesuar per zhvillimet e mjedisit ne drejtim te padeshiruar ndalet dhe percjell tek lexuesit e revistes "URAT..." te "AJMMI-t" refleksionet e tij. Me posht po botojme materialin e derguar prej tij nga Athina ku jeton aktualisht.*

Gezohem qe shikoj shoqerine, njerezimin te ecin me shpejtesi perpara, te prodhojne gjera te mira dhe te krijojne kushte per nje jetese me te mire. Me pelqen qe njeriu i sotem eshte me me teper dije e culture, tregon shqetsim per te ardhmen e globit. Biologjia dhe Bioteknologjia, zbulimet e reja te shkences, ndihmojne perdite e me shume per njohjen dhe spjegimin e fenomeneve te nderthurura te ekzistences sone.

Por shqetsohem kur shikoj e mendoj se sot, njekohesisht jetojme bashke me shume gjera negative sic jane:

-Me duart tona demtuam rende banesen tone te perbashket TOKEN. Gjate 50 vjeteve te fundit, nje siperfaqe pyjore sa siperfaqe e Europes, u zhduk( u shpyllezua). Moljpnja hectare toke e punueshme u shkretua, mbi 3000 lloje kafshe dhe bime u zhduken; jane shfaqur shume fenomene katastrofike

si permytjet, temperatyrat e larta, ciklonej.

- Shoqeria njerezore sot ka shume probleme shqetsuese sepse pjesa me e madhe e njerzve jetojne ne gjendje te varfer, papunesia rritet perdite mbi nivelin 30 – 40 perqint te popullsise se tokes., ne nje kohe kur shumica e te ardhurave te shteteve shkojne per pasurimin e disave dhe shtimin e armeve te sofistikuara.

- Familja - qeliza e shoqerise sone gjendet ne rruge qorre, pa rrugedalje ku pjesa baze e saj, te rinjte jane pa shprese per krijimin e familjes se tyre.

- Mergimi, si pasoje e papunesise, eshte sjellje epidemike deri edhe endemike duke shkaterruar shtete dhe familjen , duke humbur shpresat per nje jete normale ne vendin e tyre ame.

- U perhapskudo epidemia e narkotikeve dhe e pijeve te tjera helmuese per cdo moshe.

- Humbi njerzilleku dhe besimi midis njerzve, duke e kerkuar shpetimin jo tek dashuiuria por tek PARAJA. U trondita kur degjova ne media se ne Greqi nipi vrau gjyshin sepse ne testament shkruhej : " Pas vdekjes"

- Perparesi morren vjedhjet dhe kerrupsioni i ngjitur deri ne nivelet qeveritare, duke mos e perfillur fare varferine absolute. Keto jane plage te shumta dhe cdo dite e me e veshtire po behet nderhyrja per rikuperimin e tyre. Por une e shikij shoresen e zgjidhjes tek RINIA. Rinia eshte ajo moshe e shoqerise njerezore qe nuk do te pajtohet me kete realitet sepse ata jane realisht me te zgjuar, me te arsimuar e me nivel te lart shkencor. Ata papritmas rane ne nje kurth diktature e mbuluar me petkun e demokracise. Une e pres shume shpejt ditin kur te rinjte e cdo vendi e ne mbare boten: do te organizohen e do te marin ne dore fatin e shoqerise njerezore duke vendosur: stabilitetin, perparimin, shoqerine drejte e perparimtere. Pra nje bote ekologjikisht e paster ne kuptimin gjere te kesaj fjale..

**Nga ing.Prokop QIRJAKI**



Pejzazh, nga kalaja e Butrintit  
(FOTO: SH.H-AJMMI)

## Ceni, rosat dhe policia

Nga Bejto Gjon GERXHUNI

Ceni, miku im I vjetër, pronar I impiantit kryesor te kultivimit te midhjeve ne Liqenin e Butrintit, fiks prane vendit te quajtur "Harta" ne Ksmail, dukej sheshit që ishte i zhgënjyer nga policia. Me gjithë ate trup si prej skandinavi, tani, ishte rëgjuar dhe dukej si i futur në sallamur kur fliste për episodin e fundit.

...-C'të të them, ore byrazer...Kjo që me ndodhi me policinë e Sarandes dhe ata te SHKB-se, i thone sipas fjalës: te shkosh për lesh dhe të dalësh i qethur...!...Sapo u ktheva nga Saranda , mendova te shkoj nga punetoret qe po përgatishnin vargjet e midhjeve per t'i varur te impiantet...kur: Bamm-baam-bumm-bammm!!...Degjova arme zjarri te impiantet e midhjeve. Boboooo!-I thash gruas...me vranë punëtoret!!...Dhe me vrap u gjenda prane impianteve... Kur ç'të shoh! Disa persona po gjuanin rosa mbi kokat e punetoreve te mi...U interesova te dija me shume dhe mesova qe ishin disa punonjes te policisë! Po tani?! ...Kujt t'I ankohe?-I thashe vetes me ze sa punetoret me pane te habitur....Mora 139-n në telefon....E po, i dhahe udhe: S'ka pyll pa derra. Ua tregoj une ketyre qeratenjve!!... Alo?139?...Dhe ia qava hallin...E po,tani do zgjidhet, thash.... ne fund te fundit,,ka Ceçua biçak!..pa t'ua ndukin njëçikë veshin ketyre trimave....! Moratoriumi kunder gjuetise ne fuqi, keta bëkan kapedanin?!Prit, hiçëgjë!.....Alo?...Hiç!....C'te bëj, I ziu njeri!...Pa te marr nje here ne telefon mikun gazetar Tomken e "Shekullit", pa te shohin keta...Te dalin njehere edhe te "Shekulli" që të bën telendi.... -Alo, Tomka?...Po ku je, ore xhan I vëllait....Ore leri midhjet, po ketu eshte bere nami...poligon ....dhe nuk me degjon njeri.....!! 139-ën?...C'139, byrazer!!...Pikë vaj zotrore...nuk tundet njeri!?... Vur dorën ne zjarr e shikoje këte pune këtë cast se kam frike mos ndodh ndonjë hata me punetoret...pa le që jemi edhe ne Moratoriumin kundër gjuetisë...!

U mor edhe Tomka me kete pune por, pike vaj zotrote...! Atehere miku im më ngushëlloi . Ka edhe më sipër.Mos u mërzit! Do marr ne telefon ata te SHKB-se. ....Ahaaa,-mendova, me ata nuk ua mban.Ta bejne tete me dy!...Kur ç'të shikoj .Ia behu pas 20 minutave nje veture mu te godina ime e punes buze Liqenit. Dola me vrap...gati t'u hidhesha ne qafë.

-Avash, avash!-ma priti njeri ....Ti je Ceni? Ashtu ë?! Domethene, je

Ceni ti, dora vete ti?

-Po byrazer, une jam qe mos qofsha....Rreziku, byrazer....Po Moratoriumi I Qeverise kunder gjuetise, byrazer?...Po ç'behet kështu byrazer?.....

Kur befaz ma prenë vrullin e ligjëratës :-Ore, zoti Ceni, ti je pergjegjes I midhjeve apo i rosave që ta kuptojme mire ne, që shkule dynjanë, shkule? Nukë ke pune tjeter ti ? Këtë na thuaj ti neve?... Te ardhka keq për rosat, ty baba Ceni?...C'punë ke ti me roast, more?...Shiko more midhjet! Ate bëj!.....- Edhe iken....Une mbeta si hu gardhi I ngulur mu aty buzë Liqenit.....-Kur cërrr.... me bie telefoni disa here sa më shkundi nga fiqiri. Ishte Tomka! Gjithë gëzim sihariqi.

-Eeee?!-me tha me një doze kënaqësie prej elefanati. E pe?-me pyeti.- Ua shkulën dhëmbet atyre gjahtarëve te pacipë që të prishën gjakun ?....

Une, si guak:-Aaaa!?? Nuk më thua byrazer: kur vete të qahesh në kishë dhe ta menderos edhe prifti, dora vetë, ç'bëhet?...Ma thua dot këtë?!!

## Njerëzit e kultivuar \*



**Nga Anton CEHOV**

Njerëzit e kultivuar respektojnë individualitetin e njeriut dhe kështu që janë gjithmonë përfillës, mikpritës, të sjellshëm, të obliguar. Nuk bëjnë shume zhurme për një cekic apo një gome lapsi të humbur. Nuk ankohen nga zhurmat apo të ftohtit. Pranojnë me mirësi prezencën dhe shakate e njerezve të huaj në shtëpinë e tyre. Atyre nuk u dhimbsen vetëm me inferioret, të dobetit edhe macet. Por gjithçka. U dhemb shpirti akoma dhe për ato ç'ka nuk shikohet. Janë njerëz të drejtë dhe i tremben genjeshtrës si zjarrit. Nuk genjejnë akoma edhe për gjera të rëndomta. Genjeshtra ofendon, ata që e degjojnë dhe i poshteron në sytë e tyre ata që i thone. Nuk marrin kurrë poza, në rrugë janë

si në shtëpitë e tyre, nuk u hedhin hi syve njerezve me inferiore se ata. Nuk janë fjaleshume dhe nuk e detyrojnë tjetrin të degjojë të fshehtat e tij. Nuk perulen për të fituar dhimbshurinë e fqinjëve. Nuk lozin me kordat e ndjeshme të shpirtit të të tjerëve për të fituar si demshperblim psherëtima dhe perkëdheli. Nuk thonë: "Mua askush nuk me kupton" as: "U shita për pesë para", sepse kjo gjë, tregon se kerkojnë të të japin pershtypje të lira. (e kundërta shtrenjta). Janë truke vulgare, të venitura, të rreme. Nuk janë karrierista. Nuk merren me 'diamante' të rreme, sic është njohja me shkelqesi. Kur bëjnë punë që vlen një kopek, nuk kthehen nga puna me 100 rubla dhe nuk mburrense gjoja i lanë të shkojnë aty ku për të tjeret është e ndaluar. Krillov ka thënë që fucia bosh degjohet me shume nga ajo plot. Nëse kanë talent e respektojnë. Dhe për atë, sakrifikojnë qetesinë, gratë, vanitetin... Janë krenarë për vlerën e tyre dhe të ndergjegjshëm për rolin që kanë. Boshatisen nga shemtimi dhe kultivojnë brenda vetes së tyre, bukurinë. Nuk mundën të flenë me rroba, nuk mund të shikojnë neper murre furtare. Nuk mundën të shkelin mbi peshtyma. E zbusin dhe e persosin instiktin erotik. Nuk pine vodka kudo që të gjenden. Pine vetëm kur janë të lire dhe kur u jepet mundësia. Sepse ata kanë nevojë për "mendje të fortë në trup të fortë".



**Perktheu: Vasilika IFANDI**

\*) Fragment nga letra e shkrimtarit Anton Chehov për vëllain, Nikollai në mars 1886. Nikollai ishte një piktor i talentuar dhe shkrimtar por i zhytur në degradim. Pavarësisht nga talenti, alkoolizmi e kishte cuar atë, deri në fazën e fjetjes në rrugë. Kur mori letrën nga vëllai i tij, Nikolai ishte 28 vjeç. Letra e Cehovit, ishte një përpjekje për të ndihmuar Nikollain, të rizbulojnë rrugën e tij të jetës. Nikollai vdiq tre vjet më vonë.

## PEJSAZH



*Fabula dhe Epigrame*

Nga Vasil GJIVOGLI



**LULJA E SHKELUR**

*Diku poshte ne zallishte  
Mbijeton nje lule e brishte*

*Po nje dite nje kembe vrastare  
Shkeli lulen lozonjare*

*Heq e vuan lulja e shkrete  
Dhe renkon e mezi flet:*

*C 'te kam bere e ke ngacmova  
Vec zallishten zbukurova*

*S'jam gjembac me ligesi  
Une jam lule, o njeri*

*Dhe lotet I rrodhen krua  
E pas pak u fishk, u shua.!*

**DILEME GLOBALE**

*Ndodh te meditoj:  
Si do te veje halli\_?  
Valle,kush do fitoje,  
Zoti apo djalli*

**BURRERIA e KOKOSHIT**

*Degjon kokoshi ne mehalle  
Tek prehej shtrire ne shulle  
Nje burre qe thoshte me te qare  
<, Me fal, moj grua, nuk beje me.>*

*< E c' burre je ti, te humbte vula,  
Dhe ma heq veten burre me tru,  
Une bredherij ne njeqind pula  
E te njeqindat gati-tu.*

**MERAKU I SHQIPONJES**

*C 'marrezira perjetojme  
Mos qenka neme Perendie?!...  
Te mirin e pergojojne,  
Te ligun e vene ne krye.*

**MIKU I VERTETE**

*Pyet nje nate xixellonja:  
"C'do te thote te kesh nje mik?"  
Dhe pergjigjet shkurt shqiponja:  
"iNe dy trupa vec nje shpirt"*

**PARADOKS**

*Dhe vdiq nje dite nje plak i shkrete,  
Dhe zogjte e malit heshten.  
Por mbi varr qendronte krejt i qete  
Edhe ai qe i nxiu jeten.!*

**NENE E BABE MOS I HARRO**

*Dreri i ri plot shendet  
Mori rrugen per kurbet  
Dhe nje dite vjeshte ne pyll  
Peqafohen babe e bir*

*Dreri plak thote duke qare:  
"Udhe mbare te qofte mor djale.  
Dhe kujtoje neper vite  
Pyllin tend ku u rrite*

*Neper bote, biro ti shko  
Nene e babe mos i harro"*

**PROJEKTI ELISAA**  
E-learning  
Innovation and  
Sustainable  
Albanian  
Agriculture

**përshkrimi**

Projekti "ELISAA", i financuar nga Programi Europian EACEA (Education, Audiovisual and Culture Executive Agency)- "Tempus", ka si objektiv kryesor formimin e aftësive dhe të njohjes së profesioneve të reja, si rezultat i zhvillimit Agro-Industrial në Shqipëri, nëpërmjet një Kursi (Gratis) Specializimi (online), i përqëndruar në mundësitë e reja të ko nvertimit të biomasës pyjore dhe të mbetjeve bujqësore në biokarburant

**Nga ku?**

Projekti parashikon përdorimin e një platforme E-learning, nëpërmjet së cilës do të bëhet e mundur ndjekja e leksioneve në mënyrë autonome e komode nëpër shtëpitë e sejcilit

**si?**

Kursi i specializimit do të zhvillohet duke filluar nga Pranvera e vitit 2014

Për regjistrimin është e nevojshme të drejtoheni në sitin web [www.tempuselisaa.eu](http://www.tempuselisaa.eu) dhe të ndiqen udhëzimet e mëtejshme.

**Kur?**



E-LEARNING  
INNOVATION AND  
SUSTAINABLE  
ALBANIAN  
AGRICULTURE

**PARTNERË**

University of Bari Aldo Moro (Italia) Lead Partner  
Universiteti Bujqësor - Tiranë / Universiteti Politeknik - Tiranë / Universiteti Bujqësor "Fan Noli"-Korçë / AKTI (Agjencia Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit)  
Dhoma Tregëtisë - Fier / Dhoma Tregëtisë - Berat / Dhoma Tregëtisë - Durrës / Dhoma Tregëtisë - Lezhë / Konfindustria Shqiptare  
UnionCamere Puglia- Tirana / DYRECTA LAB S.r.l. (Italia)  
WU- Vienna University of Economics and Business Administration (Austria)  
Marie Curie- Skłodowska University of Lublin (Polonia)



PROGETTO ELISAA  
E-learning Innovation and Sustainable Albanian Agriculture  
Financuar nga Programi Europian Tempus- EACEA (Education, Audiovisual and Culture Executive Agency)- UE

**KURS FORMIMI GRATIS  
ON-LINE MBI KONVERTIMIN  
E BIOMASËS SË PYJEVE DHE E  
MBETJEVE TË AGRIKULTURAVE  
NË BIOKARBURANT**

[www.tempuselisaa.eu](http://www.tempuselisaa.eu)

Në kuadër të këtij Projekti, është parashikohet edhe një Semionar specializimi (Gratis) në Bari (Itali) për një periudhë prej 14 ditësh (Vjeshtë 2014)  
Leksion pas leksioni një person formohet si profesionist. Shumë të tillë (profesionistë) formojnë gjeneratat e reja.

Për informacione të mëtejshme mbi modalitetet e regjistrimit është e nevojshme të kontaktoni: [info@tempuselisaa.eu](mailto:info@tempuselisaa.eu)



E-LEARNING  
INNOVATION AND  
SUSTAINABLE  
ALBANIAN  
AGRICULTURE



**Parajsa e  
fshehur  
ose Gjiri i  
Manastirit i  
Shengjergjit  
(FOTO\_Ari  
THOMA)  
AJMMI**